

ARBEN AHMETAJ



Datëlindja: 28.06.1969

Vendlindja: Gjirokastrë

Email: Arben.Ahmetaj@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet në vitin 1991 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në degën gjuhë angleze, literaturë amerikane dhe angleze. Është diplomuar në degën Financë Ndërkombëtare, Tregjet Financiare Ndërkombëtare, pranë *Edmund A. Walsh School of Foreign Service*, në *Georgetown University, Washington, D.C*, më pas ka kryer studimet Master në degën Tregti Ndërkombëtare dhe Diplomaci, në *Patterson School of International Trade and Diplomacy, University of Kentucky, Lexington*.

Ai mban titullin Doktor i Shkencave në fushën e Sigurisë Energjetike, sigurisë ndërkombëtare, diplomuar në vitin 2009 në Universitetin e Bukureshtit, Rumani.

Z.Ahmetaj ka një karrierë të gjatë në administratën publike dhe ekzekutive në disa pozicione të rëndësishme. Ai ka shërbyer si ministër i Shtetit për Rindërtimin, nga 13 dhjetori 2019. Në vitin 2019, ai ka drejtuar Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave pasi mbajti detyrën e ministrit të Financave dhe Ekonomisë përgjatë periudhës shkurt 2016 – janar 2019. Në shtator 2013 – shkurt 2016, z. Ahmetaj shërbeu si ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Në vitet 2004- 2005 mbajti postin e zëvendësministrit në Ministrinë e Integritimit Evropian, ndërsa në periudhën 2003-2004 atë të zëvendësministrit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Ai ka qenë Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në vitin 1998-1999. Në vitet 1997-1998 ai shërbeu si drejtor i

kabinetit në Ministrinë e Financave dhe përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare, anëtar i grupit të koordinimit të negociatave me Fondin Monetar dhe për konkretizimin e marrëveshjes postkonfliktuale me ESAF. Eksperienca të tjera profesionale të z. Ahmetaj janë edhe detyra si Këshilltar për çështjet fiskale në Bankën Amerikane të Shqipërisë; në Bankën e Shqipërisë si dhe ka punuar pranë Fondit Monetar Ndërkombëtare (1993-1995).

Ka kryer disa kualifikime si internship mbi programet e financimit të fermerëve, Farmers Credit Union of Texas, Texas University (1992), internship me temë “The economics of technology”, Kokkalis Program në Harvard Kennedy School, Harvard University (maj 2004). Gjithashtu, ai është kualifikuar për “Politikat e Zhvillimit” nga Qendra për Zhvillim Kombëtar, Harvard Kennedy School, Harvard University (tetor 2014).

Z. Ahmetaj është anëtar i Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste. Ka qenë anëtar dhe Kryetar i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Në vitin 2009 u zgjodh deputete në Kuvendin e Shqipërisë ku përfaqësoi qarkun e Korçës dhe më pas në zgjedhjet e vitit 2013, atë të Gjirokastrës.